

Të dashur qytetarë,

Mandati i kaluar ishte mandati i forcimit të shtetit social dhe i shtrirjes së sovranitetit të Republikës në çdo cep të Kosovës. Ishte mandati i përkujdesjes për nënat dhe fëmijët, i fuqizimit të ushtrisë, i investimeve strategjike në bujqësi dhe i vendosjes së rendit, ligjit dhe autoritetit të shtetit deri në veriun e vendit. Këto nuk janë masa kalimtare. Janë themele të shtetit tonë. Dhe mbi këto themele vazhdon ngritja e Republikës.

Mandati i ri është mandati i transformimit të madh ekonomik dhe industrial të Kosovës. Mandati i prodhimit, i zhvillimit dhe i vetëqëndrueshmërisë. Investime strategjike në sektorin minerar, në kapacitetet energjetike dhe në gazifikimin e qymyrit, si bazë e zhvillimit industrial dhe e sigurisë energjetike të vendit. Shtet që prodhon, ndërton dhe fuqizohet nga puna e vet.

Katër hekurudha të reja, pesë diga me investime mbi 400 milionë euro dhe 20 stadione moderne me investime prej 250 milionë eurosh. Shtet që lidh qytetet, zhvillon ekonominë dhe ndërton infrastrukturë për brezat që vijnë. Zhvillim i turizmit strategjik, me investime në Brezovicë dhe me shndërrimin e Dukagjinit në një qendër të re turistike e zhvillimore. Shtet që e kthen pasurinë natyrore në zhvillim dhe mirëqenie.

Ngritje e industrisë ushtarake të Kosovës. Prodhim vendor i municionit, pajisjeve ushtarake dhe teknologjisë bashkëkohore të dronëve luftarakë. Shtet që mbron veten dhe forcon sigurinë e tij. Themelim i Byrosë për konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë së pajustificueshme, si goditje e drejtpërdrejtë ndaj korrupsionit dhe pasurimit të paligjshëm. Shtet ku ligji është mbi secilin dhe pasuria e paligjshme nuk gjen strehë.

Ne jemi bërë bashkë për shtet social që mbron qytetarin dhe familjen, shtet sovran që ushtron autoritet ngado, shtet zhvillimor që prodhon, investon dhe ndërton, shtet ligjor që lufton korrupsionin dhe pasurimin e paligjshëm. Shtet i sigurisë dhe mbrojtjes, me ushtri të fuqishme dhe industri ushtarake vendore. Shtet energjetikisht i qëndrueshëm dhe ekonomikisht më i pavarur. Shtet që mbështet punën, prodhimin vendor dhe fermerin. Shtet me infrastrukturë, hekurudha, diga dhe zhvillim industrial. Shtet që investon në dije e teknologji. Shtet që ruan dinjitetin e luftës çlirimtare dhe kujtesën kolektive. Pra, shtet për krejt, pa lënë askënd anash.

Që ta jetësojmë këtë program dhe këto zotime, nevojitet angazhimi i secilit prej nesh, në këto ditë, gjatë gjithë fushatës dhe veçanërisht më 7 qershor, në ditën e zgjedhjeve. Asnjëri prej nesh nuk duhet të mungojë atë ditë. Sepse ne jemi krejt për shtet.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

PROD HIMTARI E NDËRMARRËSIA

Për prodhimtarinë, industrinë dhe ndërmarrësinë ne do të veprojmë përmes Bankës zhvillimore, programit 1 miliardë euro në prodhim dhe ndihmës së bizneseve.

Banka Zhvillimore

Përmes Bankës Zhvillimore do të mbështeten projektet strategjike dhe prioritare përmes financimit të drejtpërdrejtë të kompanive.

Përmes skemave të nënhuazimit, duke shfrytëzuar sektorin bankar, do të mbështeten ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe individët, për investime në fushat prioritare me kushte të favorshme financimi.

Ndërkaq, përmes letërgarancive për pagesa do të ndihmohen prodhuesit dhe eksportuesit që të kenë qasje më të lehtë në financim dhe likuiditet.

Programi 1 miliardë euro për prodhim dhe industri

Përmes Programit 1 miliardë euro për prodhim dhe industri do të mbështeten projektet strategjike dhe prioritare të industrisë, përfshirë industrinë kreative, përmes financimit të drejtpërdrejtë të kompanive dhe skemave të subvencionimit të pagave.

Për të ndërtuar një ekonomi më të qëndrueshme dhe vende pune me paga më të larta, do të mbështeten investimet në kapacitete prodhuese përmes garantimit të kredive për investitorët, në vlerë prej 1 miliard eurosh.

Secili investitor do të ketë mundësinë të përfitojë nga garancia shtetërore për kredinë e nevojshme për investim, duke siguruar qasje më të lehtë në financim dhe kosto më të ulët të kreditimit.

Amortizimi i përshpejtuar për investimet e reja

Bizneset që realizojnë investime të reja do të përfitojnë nga amortizimi i përshpejtuar, duke mundësuar që një pjesë më e madhe e vlerës së investimit të zbritet në vitet e para të përdorimit. Kjo ul detyrimet tatimore në fazën fillestare të investimit, kur kostot për biznesin janë më të larta, dhe u lë kompanive më shumë mjete financiare në dispozicion për paga, lëndë të parë, zgjerim të prodhimit dhe investime të reja.

Përmes kësaj mase përmirësohet likuiditeti i bizneseve dhe lehtësohet zhvillimi i kapaciteteve prodhuese.

FINANCAT PUBLIKE

Terminalet

Shtetit ia kemi kthyer терминаlet doganore, ashtu që të mos ketë më kosto zhvatëse për tregtinë e jashtme. Siç u patëm zotuar, të gjitha терминаlet doganore janë tashmë publike. Paralelisht, kemi nisur planifikimin e investimeve për modernizimin dhe zgjerimin e tyre.

Faturimi elektronik ndërmjet bizneseve

Në tremujorin e parë të këtij viti nisi zbatimi i projektit për pajisjen me arka fiskale digjitale.

Kemi zhbërë monopolin në këtë sektor dhe ua kemi lehtësuar barrën bizneseve.

Punën do ta vazhdojmë me sistemin e ri të faturimit elektronik ndërmjet bizneseve, i cili do të mundësojë monitorim në kohë reale të detyrimeve të TVSH-së dhe rimbursim më të shpejtë e automatik. Më pak kontrolle për bizneset dhe më shumë lehtësi për rimbursimin e TVSH-së.

Pagesa e TVSH-së

Për të mbështetur likuiditetin e bizneseve, pagesa e TVSH-së për mallrat që hyjnë në kufi do të zhvendoset nga kufiri në deklarimin brenda vendit. Data e pagesës së detyrimit do të kalojë në muajin pasues nga muaji kur lind detyrimi në kufi, ngjashëm me mënyrën e deklarimit të TVSH-së së brendshme.

Taksa doganore për veturat

Për veturat e importuara nga vendet e Bashkimit Evropian do të hiqet taksa doganore prej 10%, duke ulur koston e blerjes për qytetarët.

Çmimet tavan

Ligji për çmimet tavan, i miratuar këtë pranverë, do të ndihmojë në parandalimin e abuzimeve me marzhet tregtare dhe manipulimeve në treg, në mbrojtje të konsumatorëve dhe tregtarëve të ndershëm.

INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA

Kemi qenë dhe do të vazhdojmë të jemi qeveria që investon më së shumti në inovacion, teknologji dhe zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit.

Valuta Digjitale

Në mandatin e ri do të nisim zhvillimin e Valutës Digjitale të Kosovës. Valuta digjitale, e bazuar në teknologjinë blockchain dhe e zhvilluar nga shteti, do të përdoret për pagesa dhe shërbime digjitale. Kjo nismë do të nxisë inovacionin, zhvillimin e teknologjisë financiare dhe ekosistemin e start-up-eve inovative, duke e vendosur Kosovën në rrjedhat më të avancuara të zhvillimit teknologjik.

ICT Tower

Për kompanitë e teknologjisë së informacionit që po dëshmojnë rritje të qëndrueshme dhe potencial në punësim, do të ndërtohet ICT Tower – Kulla TIK, si investim publik në qendër të Prishtinës. Kjo hapësirë do të shërbejë si qendër e zhvillimit teknologjik, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet kompanive të sektorit.

Mbështetje për Industrinë e IT-së

Kompanitë e sektorit të IT-së do të mbështeten me hapësira dhe objekte në qytetet kryesore të Kosovës. Njëkohësisht, do të hiqen kufizimet për njohjen e shpenzimeve të trajnimit si shpenzime të zbritshme, me qëllim të zhvillimit të kuadrove profesionale dhe rritjes së konkurrueshmërisë së industrisë.

ITP

Fondi i Inovacionit dhe Rinia

Përmes Fondit të Inovacionit do të mbështeten të rinjtë, start-up-et dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit. Fondi do të financojë zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve të reja, duke nxitur kreativitetin dhe ndërmarrësinë e të rinjve të Kosovës.

Parqet e Inovacionit

Do të vazhdojë ndërtimi i infrastrukturës së inovacionit dhe ndërmarrësisë, përmes Parqeve të Inovacionit dhe Teknologjisë, qendrave të inovacionit dhe inkubatorëve teknologjikë, të biznesit dhe industrialë. Këto projekte do të vendosen në komuna dhe universitete, duke lidhur arsimin, aftësimin profesional dhe industrinë me kërkesat e tregut dhe zhvillimin e teknologjive të avancuara.

THEMELIMI I KOMPANISË AJRORE PUBLIKE - AVIACIONI CIVIL

Brenda mandatit do të nisim procesin për themelimin e një kompanie ajrore me kapital publik, në partneritet me aktorë të rëndësishëm të industrisë së aviacionit brenda dhe jashtë vendit.

Në të njëjtën kohë, do të investohet në shkollimin, trajnimin dhe certifikimin e specialistëve të aviacionit civil, për të krijuar kapacitete profesionale vendore dhe për të zhvilluar një sektor të qëndrueshëm të aviacionit në Kosovë.

TRANSPORTI PUBLIK

Programi “Anembanë”

Transporti publik në vendin tonë është një nga fushat ku kërkohet shumë angazhim dhe transformim.

Do të fillojmë me jetësimin e Programit “Anembanë”. Do të krijojmë rrjetin e integruar të transportit publik në tërë territorin e vendit.

Fillimisht e nisim me trafikun urban në secilën komunë. Hapi pasues vijon me trafikun ndërurban.

Do të ketë biletë mujore të integruar. Secili shfrytëzues do të mund të udhëtojë anembanë Kosovës, pa pasur nevojë për biletë tjetër, dhe duke përdorur vetëm transportin urban dhe ndërurban.

Një biletë – një çmim

Bileta do të jetë e subvencionuar dhe me kosto minimale për shfrytëzuesit. Synimi është që, me një kosto të përballueshme prej 10 euro/muaj, secili të ketë mundësi të shfrytëzojë programin “Anembanë”.

TURIZMI MALOR

Brezovica

Këtë mandat të ri e nisim me projektin e madh “Brezovica”.

Grupi punues për këtë projekt, i drejtuar nga Ministri i Financave, nis punën menjëherë në fillim të mandatit.

Ne do të investojmë deri në 500 milionë euro në infrastrukturë rrugore, akomodime moderne, pista të reja e rrjet bashkëkohor të teleferikut.

Do të sigurohemi që Brezovica të bëhet e famshme jo vetëm në rajon por edhe në Evropë e botë. Zhvillimi i këtij projekti do të jetësohet nëpërmjet dy komponentëve. Komponenti i parë është infrastruktura përcjellëse, ndërtimi dhe mirëmbajtja e saj. Ndërkaq, komponenti i dytë do të jetë pjesa e ndërtimit dhe operimit të hotelërisë, gastronomisë, shërbimeve rekreative, sportive e të tjera.

Dukagjini

Në rajonin e Dukagjinit, në Pejë, në Bjeshkët e Nemuna dhe në Rugovën tonë të jashtëzakonshme, do të zhvillojmë **Qendrën turistike Dukagjini**.

Këto investime do të realizohen duke investuar dhe bashkërenduar të gjithë hapat institucionalë për të finalizuar projektin më të madh të turizmit malor, i cili do të zhvillohet në harmoni të plotë me mjedisin dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke qenë se ky projekt shtrihet në një zonë të mbrojtur, ai do të përfshijë infrastrukturën përcjellëse, kapacitetet akomoduese, shërbimet turistike, rekreative dhe sportive, të projektuara me standardet më të larta ekologjike për të garantuar ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore për brezat e ardhshëm.

Ekoturizmi - ekonomi

Një nga vendimet kryesore të mandatit të ardhshëm është projekti për ringjalljen e Bjeshkëve të Nemuna dhe Sharrit përmes granteve specifike për shndërrimin e staneve në bujtina ekologjike, duke ruajtur traditën dhe duke fuqizuar ekonominë lokale në çdo familje në zonat e mbrojtura.

Zhvillim i qëndrueshëm i Malësisë së Gollakut dhe Shalës së Bajgorës

Transformimi i këtyre dy zonave është jetike për gjallërimin e turizmit dhe ekonomisë në malësitë e Gollakut dhe Shalës së Bajgorës. Do të kryejmë investime strategjike në infrastrukturë bazike, bujqësi dhe mbrojtje të natyrës për t'i kthyer shtëpitë e banorëve të zonës në qendra të ekoturizmit e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.

MËRGATA

Krahas nismave që ndërmorëm gjatë qeverisjes, do të shtojmë përpjekjet dhe programet që fuqizojnë pjesëmarrjen e mërgatës në vend.

Garancia për kredi investuese

Përmes “Dritares për Investime të Diasporës” do të mbështeten ndërmarrës nga diaspora deri në 100 milionë euro investime që realizohen në Kosovë.

Shteti i Kosovës do të jetë garant për investimet e mërgatës.

Për të gjitha kreditë që merren për investimet e tyre këtu, shteti i Kosovës do të shërbejë si hipotekë për ta.

Bashkërendim – dije - teknologji

Në Prizren, në Parkun e Inovacionit dhe Teknologjisë do ta zhvillojmë Qendrën e parë të Kosovës për hulumtim dhe zhvillim në fushën e energjisë, në bashkëpunim me partnerët gjermanë, akademinë dhe profesionistët nga mërgata jonë. Një qendër që do të zhvillojë zgjidhje për energji të sigurt, të përballueshme dhe të qëndrueshme për Kosovën. Sepse zhvillimi nuk vjen vetëm nga resurset që kemi, por nga dija, teknologjia dhe aftësia për t’i kthyer ato në fuqi ekonomike e shtetërore.

Transferi i parave

Kemi kryer të gjitha obligimet që i paraprijnë integritet të Kosovës në “Single European Payment Area”.

Kështu do të krijohen lehtësi të mëdha për transferet e parave në Kosovë.

Me anëtarësimin në SEPA, rreth 60 milionë euro do t’i kursejë Kosova nga paratë që mërgata jonë paguan për transferet e parave drejt familjeve të tyre.

Gjuha shqipe

Mësimi i gjuhës shqipe me kurrikul të dedikuar për fëmijët e familjeve që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit është prioritet që do të mbështetet pa kursim.

Së bashku me Shqipërinë do të sigurohemi që të zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shtetet ku ka komunitet të madh shqiptar.

Po ashtu, do të punojmë që sa më shumë familje t’i dërgojnë fëmijët e tyre të lindur në shtetet përkatëse në kurset e gjuhës shqipe.

Shërbimet konsullore

Do t’i digjitalizojmë plotësisht shërbimet konsullore.

Çdo pjesëtar i mërgatës sonë nuk do të ketë më nevojë që, për shumicën e shërbimeve administrative, të paraqitet patjetër fizikisht në konsullata dhe ambasada.

Shtetësia

Qeveria do të mundësojë kthimin me automatizëm të shtetësisë së Kosovës për pjesëtarët e mërgatës të cilët e kanë humbur atë për shkak të kufizimeve në shtetin ku jetojnë apo rrethanave të tjera historike. Tashmë është miratuar ligji dhe po nis zbatimi i kësaj politike.

FAMILJA

Ne i kemi mbështetur familjet, nga subvencionimi i energjisë elektrike deri te shtesat për fëmijë. Në mandatin e ri po shtojmë edhe një program të ri, të dedikuar për gjyshërit në familjet me fëmijë.

Gjenerata për gjeneratë

Në kuadër të mbështetjes për familjen, do të nisim skemën e mbështetjes për gjyshërit pensionistë që kujdesen për nipat dhe mbesat, në rastet kur të dy prindërit punojnë.

Secila gjyshe apo secili gjysh pensionist që përkujdeset për mbesa dhe nipa të moshës 13–36 muaj, kur të dy prindërit janë në punë, do të përfitojë 100 euro shtesë në muaj mbi pensionin ekzistues.

Përveç rritjes së mirëqenies për gjyshërit pensionistë, ky program synon ruajtjen dhe forcimin e familjes, duke afruar tri gjenerata pranë njëra-tjetrës dhe duke mundësuar pjesëmarrje më të madhe të grave në tregun e punës.

Nënat e reja

Edhe për nënat lehona kemi vepruar me përkushtim.

Fillimisht nisëm shtesat prej 170 euro në muaj, sa ishte paga minimale. Në vitin 2025 ato u rritën në 325.9 euro. Ndërsa, në maj 2026, shtesat u rritën në 500 euro në muaj për 6 muaj, sepse atëherë do të jetë paga minimale nga korriku.

Pra, 3,000 euro për secilën nënë lehonë pa punë, përveç shtesave mujore për fëmijët.

Fëmijët

Shtesat për fëmijë nuk ekzistojnë kur nisëm qeverisjen. Sot ato janë nga 30 deri në 45 euro për çdo fëmijë.

Në mandatin e ardhshëm do t'i dyfishojmë shtesat për fëmijë: nga 30 në 60 euro dhe nga 45 në 90 euro për çdo fëmijë.

GRATË

Superpuna për Gratë

Paralelisht me masat për mbështetjen e vajzave në studime, grave në biznes, nënave me fëmijë, artisteve dhe sportisteve, në 6 muajt e parë të mandatit të ri do të nisë Programi i Superpunës për Gratë.

Programi do të garantojë pagën minimale për 6 muajt, e cila nga korriku do të jetë 500 euro. Ai u dedikohet grave pa kufizim moshe që duan të hyjnë ose të rikthehen në tregun e punës, duke u mundësuar punësim, të ardhura dhe përvojë pune.

Për bizneset, punësimi i grave bëhet më i leverdishëm, sepse paga për 6 muajt e parë mbulohet nga shteti. Për gratë, krijohen mundësi reale për punësim dhe rikthim në jetë aktive ekonomike e shoqërore.

Ky model ka dëshmuar sukses me të rinjtë. Në mandatin e ri do të zgjerohet për të gjitha gratë.

PUNËTORËT

Paga

Paga minimale nuk do të tatóhet. Nga korriku, paga minimale do të jetë 500 euro. Kjo nënkupton se edhe për biznesin e vogël individual, 6,000 eurot e para të fitimit vjetor do të jenë të liruara nga tatimi.

Paga mesatare në sektorin publik, me trendin aktual, e kalon 1,000 euro. Gjatë mandatit të fundit, buxheti për paga është rritur për 47% dhe, me vazhdimin e rritjes ekonomike, do të vazhdojë edhe rritja e pagave.

Raporti ndërmjet pagës më të ulët dhe asaj më të lartë është përmirësuar nga 20:1 në 4:1. Pra, janë rritur pagat dhe është zvogëluar pabarazia.

Gjatë vitit 2026, në konsultim me bizneset dhe punëtorët, do të ndërmerret nisma ligjore për përcaktimin e pagës e 13-të në sektorin publik dhe privat me synim planifikimin gradual edhe të pagës së 14-të. Çdo familje duhet të ketë më shumë siguri për pushimet, shpenzimet sezonale dhe nevojat familjare.

Këto masa ndihmojnë bizneset në ruajtjen e fuqisë punëtore, ulin largimin e punëtorëve dhe rrisin sigurinë ekonomike e motivimin në vendin e punës.

Sigurimi i pagës pas humbjes së punës – Fondi i Sigurimeve Shoqërore

Kushdo që humb vendin e punës nuk do të mbetet më pa të hyra menjëherë. Fondi i Sigurimeve Shoqërore do të garantojë mbështetje financiare për çdo punëtor në rast nevojë dhe mbulim për një periudhë të caktuar deri në gjetjen e një vendi të ri pune.

Ky fond do të mbulojë edhe pagesën e pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror, si për nënën ashtu edhe për babain.

Mbrojtja e të Drejtave

Për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe sigurinë në punë, në mandatin e ri do ta rrisim sërish numrin e inspektorëve të punës, deri në 200 inspektorë.

Do të digjitalizohet plotësisht sistemi i raportimit dhe menaxhimit të rasteve të shkeljes së të drejtave në punë, në mënyrë që asnjë rast të mos mbetet pa trajtim, pa monitorim dhe pa përgjegjësi. Çdo shpërfillje apo abuzim do të jetë i gjurmueshëm, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe mbrojtjen e punëtorëve

Ligji i ri i punës do të vendosë standard të ri bashkëkohor për të drejtat dhe sigurinë e punëtorëve. Siguria ligjore për punëtorin në sektorin privat dhe publik duhet të jetë e barabartë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet garantimit të plotë të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, paralelisht me zhvillimin e ndërmarrësisë, si dhe rritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies në sektorin publik.

STUDENTËT

Në vitin e parë ne hoqëm pagesën e studentëve duke e bërë falas shkollimin në Universitetet publike.

Ne kemi një seri programesh të bursave të bazuara në merita dhe prioritetet strategjike shtetërore që i kemi aplikuar gjatë mandatit që po përfundon.

Bursat “Mobiliteti për studentë”

Me qeverinë në detyrë gjatë vitit 2025, e kemi realizuar zotimin tonë për bursat e mobilitetit dhe mbështetjen për të gjithë studentët.

Me këtë program, mbështeten të gjithë studentët në nevojë, të cilët kryejnë studimet në një lokacion tjetër nga ai ku jetojnë.

Studentët që kualifikohen për programin e bursës **“Mobiliteti për studentë”**, për çdo muaj do të marrin një bursë. Shuma varet nga distanca midis vendit ku studiojnë dhe vendit ku jetojnë. Sa më larg të kenë nevojë të studiojnë, aq më shumë do të përfitojnë.

Qeveria për të gjithë studentët

Pasi që rritëm mbështetjen për studentët në universitetet publike dhe për studentet vajza e gra në STEM, mbështetjen me bursa do ta zgjerojmë edhe për studentët që vijojnë studimet në shkollimin universitar jopublik, pra në kolegje private.

Për këtë, do të dyfishojmë buxhetin e ndarë për bursa nga ai që kemi aktualisht.

SHKOLLA – UNIVERSITETI – DIJA

Edukimi i fëmijëve

Do të vazhdojë me prioritet të lartë mbështetja për edukimin e hershëm. Vendi ynë ka **108 mijë fëmijë** 1–5 vjeç.

Krahas rritjes së përfshirjes së tyre në çerdhet publike, do të nisë edhe sistemi i bonove për prindërit që vendosin t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe jopublike.

Synimi është që në ciklin parafillor të përfshihen të gjithë fëmijët nga mosha 5–6 vjeç.

Aktualisht, në vend janë **20 mijë fëmijë** në këtë moshë.

Mësimdhënësit sipëror

Për të diplomuarit në fushën e pedagogjisë, hyrja në profesion do të bëhet pas licencimit në nivel shtetëror, në rast aplikimi për mësimdhënës në nivelin parauniversitar.

Licencimi i avancuar i mësimdhënësve në nivelin sipëror do të shoqërohet me rritjen e pagesës së tyre.

Gjatë vitit 2025 u realizua ky proces për mësuesit e klasave 1–5 dhe ata të gjuhës dhe matematikës.

Gjatë mandatit të ri, do të shtrihet për të gjitha nivelet dhe profilet.

Tekste shkollore cilësore

Do të vijojë dhe thellohet procesi i rishikimit dhe rivlerësimit të të gjitha teksteve shkollore.

Nga gjuha dhe matematika, që i rishikuan tashmë, do të vazhdojmë me të gjitha tekstet e tjera për arsimin parauniversitar.

Për disa lëndë, do të nisë përkthimi dhe digjitalizimi i materialeve shkollore.

Mësimi plotësues

Mësimi plotësues po përgatitet si program i veçantë dhe i shtrirë në të gjitha shkollat e vendit.

Me të, nis vala e re për transformimin cilësor të mësimdhënies në shkollat tona.

Pesë gjimnaze të reja dhe bonus për angazhimin në shkolla të largëta

Do të hapen pesë gjimnaze të specializuara për shkenca natyrore, teknologji, gjuhë dhe arte. Për profesionistët me doktoraturë dhe kualifikim të lartë që angazhohen në shkollat e komunave më të largëta, do të ketë bonus të veçantë për angazhimin e tyre.

Shkolla gjithëditore, standard i ri i arsimit

Do të nisim zbatimin e shkollës gjithëditore me shtrirje graduale në shkollat e vendit, me artin, sportin dhe mësimin digjital si pjesë të programit. Investimet në përmbajtje, infrastrukturë, laboratorë, kabinete dhe aktivitete jashtëkurrikulare do të krijojnë kushtet për organizimin e mësimi gjithëditor.

Këtë vit në bashkëpunim me Ministrinë e Sportit do të nisim fillimin e garave shkollore në sporte kolektive e individuale si hap i parë drejt ligave të shkollave.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Për fëmijët me nevoja të veçanta, do të kemi program të zgjeruar ndihme në shkollë, me logoped, psikolog, aktivitet sportiv dhe aktivitete rekreative të veçanta.

Shkolla profesionale cilësore, të lidhura me industrinë

Për arsimin dual dhe profesional do të krijojmë platformën me profilet e secilit të diplomuar për qasje në tregun e punës.

Do të shtohen 10 profile të reja në mësimin dual, duke iu bashkangjitur 16 profileve aktuale, në përputhje me kërkesat e industrisë.

Në arsimin profesional do të vijojë forcimi me investime në mjete mësimore, marrëveshje me industrinë dhe fushat ku përgatiten nxënësit.

Këshillimi në karrierë

Krahas këtyre masave do të krijojmë shërbimin profesional të këshillimit në karrierë në shkolla, me këshilltarë të trajnuar dhe orientim të hershëm të nxënësve drejt profesioneve që kërkohen në tregun e punës në Kosovë.

Shkolla e digjitalizuar

Digjitalizimi i certifikatave dhe materialeve shkollore dhe finalizimi i një platforme të centralizuar digjitale për menaxhimin e shkollave, ditarëve dhe materialeve digjitale janë hapat e radhës. Klasat do t'i pajisim me tabela të mençura.

Do të shtrijmë internet me shpejtësi të lartë në **1000 institucione** të arsimit parauniversitar, duke siguruar qasje falas në internet.

Ristrukturimi i arsimit të lartë, universitete me profile të qarta

Universitetet publike do të profilizohen sipas drejtimeve kërkimore-shkencore dhe aplikative. Do të mbështeten programet e kërkimit shkencor dhe do të nisë financimi i universiteteve publike bazuar në performancë dhe cilësi akademike.

Të ardhura shtesë mbi pagën bazë për profesorët

Përmes ristrukturimit të fondit të shkencës dhe fuqizimit të instituteve universitare, profesorëve universitarë do t'u krijohen mundësi për të ardhura shtesë mbi pagën bazë, përmes punës shkencore, shërbimeve profesionale dhe projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Qendra e Studentëve

Në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", do të ndërtojmë një konvikt të ri dhe tre salla të reja për bibliotekën universitare brenda Qendrës së Studentëve.

MBROJTJA E SHËNDETIT

Çdo qytetar i yni do të ketë mjekun familjar dhe do të jetë brenda Regjistrit të kujdesit parësor shëndetësor.

Check-up shëndetësor për çdo qytetar

Prej vitit të ri fillon plani për kontrollin dhe mbikëqyrjen shëndetësore për çdo qytetar.

Brenda vitit, secili e secila do të ketë një kontroll të plotë mjekësor.

Sistemi, i njohur si check-up, do të parandalojë, ndihmojë dhe mbështesë çdo rrezik që vjen nga problemet shëndetësore.

Vizitat parandaluese të rregullta për grupmoshat e rrezikuara do të standardizohen në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, me qëllim zbulimin e hershëm dhe parandalimin e sëmundjeve malinje. Përmes programeve të organizuara të depistimit, do të ofrohen kontrole të rregullta për kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës dhe kancerin kolorektal, duke rritur qasjen e qytetarëve në shërbime parandaluese dhe duke përmirësuar rezultatet e trajtimit.

Mbrojtja që fëmijërinë e hershme

Përmes investimeve në kujdesin parësor shëndetësor, do të forcohet mbështetja për nënat dhe fëmijët që nga periudha e shtatzënisë deri në moshën 6-vjeçare. Përveç kontrolleve të rregullta për gratë shtatzëna dhe vizitës pas lindjes në shtëpi, çdo fëmijë deri në moshën 6 vjeç do të ketë vizita të rregullta zhvillimore. Në rastet kur identifikohen nevoja specifike, në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor do të ofrohen shërbime të specializuara logopedike, fizioterapeutike, psikologjike dhe sociale, me qëllim ndërhyrjen e hershme dhe mbështetjen e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve.

Shëndeti preventiv dhe aktivizimi fizik i qytetarëve

Do të nisim një program të ri për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies fizike e mendore. Kështu, parandalimi, aktiviteti fizik dhe mirëqenia do të bëhen pjesë e jetës së përditshme komunitare. Përmes programit “Lëvizim për Shëndet”, në bashkëpunim me Ministrinë e Sportit, komunat dhe shkollat, do të themelohen programe dhe do të nisin investime publike që sigurojnë aktivitete rekreative dhe sportive në të gjitha komunat, me synim promovimin e jetesës së shëndetshme dhe parandalimin e sëmundjeve kronike.

Siguria ushqimore dhe shëndeti Publik

Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, do të ndërtojmë një sistem të avancuar dhe të integruar të kontrollit të ushqimit, me standarde bashkëkohore të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik. Do të fuqizohen kapacitetet inspektuese dhe laboratorike për kontrollin e cilësisë së prodhimeve bujqësore, blegtorale dhe të të gjitha produkteve që konsumohen nga qytetarët.

Përmes monitorimit më të rreptë, analizave laboratorike dhe gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore, do të rrisim sigurinë e ushqimit dhe do të forcojmë parandalimin e sëmundjeve që lidhen me ushqyerjen dhe cilësinë e produkteve në treg. Siguria ushqimore do të trajtohet si çështje qendrore e shëndetit publik dhe mirëqenies së qytetarëve.

Sigurimet shëndetësore

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për sigurimet shëndetësore, dhe kompletimit të sistemit informativ shëndetësor, hapet rruga drejt funksionalizimit përfundimtar të sistemit të sigurimeve shëndetësore.

Aktualisht, shërbimet shëndetësore në institucionet publike mbulohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Sigurimet shëndetësore nuk nënkuptojnë ‘shërbim falas’, ato janë mekanizëm solidariteti dhe mbrojtjeje sociale, i financuar nga shteti, punëdhënësit dhe të punësuarit, në mënyrë që askush të mos përballet me varfërim apo falimentim si pasojë e një sëmundjeje apo ngjarjeje të rëndë shëndetësore.

Mbulimi i kostos së barnave jashtëspitalore

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për sigurime shëndetësore përfitimi i parë për qytetarët është lista e rimbursueshme. Lista e rimbursueshme e barnave fillon për herë të parë, duke mbështetur qytetarët për shpenzimet e barnave jashtëspitalore.

Për listën esenciale të barnave, buxheti do të rritet deri në 100 milionë euro.

Gjithashtu, çmimet e barnave janë unifikuar në të gjithë territorin e vendit dhe janë të përbalueshme për çdo familje.

Secili qytetar, me letërnjoftimin dhe recetën e lëshuar nga mjeku, do të mund të paraqitet në barnatore dhe të pajiset me barnat nga lista e subvencionuar.

Shërbime mjekësore specialistike anembanë

Në mandatin e ri do të decentralizojmë në tërësi shërbimet shëndetësore.

Nga punët e para në këtë drejtim do të jenë shërbimet mjekësore onkologjike në spitalet e përgjithshme.

Kështu, të sëmurët do të kursehen nga udhëtimi dhe mundimi.

Krahas tyre, do të sigurohen edhe shërbimet e dializës aty ku ende nuk ofrohen. Si dhe do të sigurohen pajisje të reja në çdo repart ku ofrohet ky shërbim.

Për këtë do të investojmë në çdo spital rajonal, duke shtuar pajisje, shërbime të reja dhe infrastrukturë moderne.

Gjatë vitit 2026 do të zbatohet plani për funksionalizimin e shërbimit të rezonancës magnetike në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, Ferizajt dhe Gjilanit, ndërsa në QKUK do të vendoset në përdorim rezonanca magnetike 3 Tesla e teknologjisë së fundit.

Spitalet dhe klinikat e reja dhe të rinovuara

Do të ndërtohen spitalet e reja në Mitrovicë dhe Ferizaj. Spitalet e përgjithshme në të gjithë vendin do të transformohen përmes investimeve në infrastrukturë, teknologji mjekësore dhe zgjerim të shërbimeve shëndetësore.

Spitalet do të kenë pajisje diagnostike, laboratorë të avancuar për realizimin e analizave dhe shërbime bashkëkohore.

Gjatë fillimit të mandatit çdo spital publik në vend do të pajiset me shërbimin e tomografisë kompjuterike (CT), duke garantuar qasje të barabartë në diagnostikim për qytetarët në të gjitha rajonet.

Cilësi e mjekimit - edukim e hulumtim shkencor

Do të rritet dhe intensifikohet programi i trajnimit profesional dhe specializimit të stafit shëndetësor, me fokus në shërbimet deficitare të sistemit publik dhe avancimin e stafit të mesëm mjekësor. do të fuqizohet bashkëpunimi me universitetet brenda dhe jashtë vendit për zhvillimin e edukimit mjekësor, kapaciteteve klinike dhe programeve të përbashkëta profesionale. paralelisht, do të rriten investimet në hulumtime klinike për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe kushtet e punës për profesionistët shëndetësorë.

Poliklinikat specialistike

Poliklinikat specialistike do të ndërtohen në Drenas, Sharr, Podujevë, Viti, Rahovec dhe Leposaviq.

Ato do të ofrojnë shërbime publike të specializuara, duke e lehtësuar marrjen e kujdesit mjekësor dhe duke ulur shpenzimet për buxhetin familjar.

Poliklinikat specialistike stomatologjike publike

Do të hapim poliklinikat specialistike stomatologjike në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë, Ferizaj dhe Podujevë.

Këto klinika do të ofrojnë shërbime stomatologjike publike cilësore dhe të përballueshme.

Laboratorë të avancuar publikë

Do të ndërtojmë rrjetin e laboratorëve publik që mbulojnë të gjitha llojet e analizave.

Kostoja e shërbimeve do të jetë e përballueshme për çdo qytetar.

Mbështetje e industrisë farmaceutike vendore

Nëpërmjet programit 1 miliardë euro për prodhuesit do të synojmë të mbështesim prodhimin e produkteve medicinale brenda vendit si një masë strategjike për sigurinë e furnizimit.

PRODHIMI – EKONOMIA BUJQËSORE

Gjatë qeverisjes sonë, përmes mbështetjes më të madhe për bujqësinë në rajon, ua rikthyem fermerëve besimin se mbështetja shtetërore ndahet drejt dhe se nga puna në bujqësi mund të jetohej e të fitohet me dinjitet. Mbi 120 mijë fermerë kanë përfituar mbi 300 milionë euro në grante dhe subvencione, ndërsa për herë të parë mbështetja ka shkuar te fermerët realë, duke ndalur abuzimet dhe shpërdorimet që për vite me radhë e kanë dëmtuar sektorin e bujqësisë.

Siguri për fermerin – siguri ushqimore për shtetin

Në mandatin e ri, përqendrimi ynë do të jetë në rregullimin e tregut të prodhimeve bujqësore, rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, sigurinë ushqimore, përmes mbështetjes së investimeve në teknologji dhe në rrjetëzimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore. Pas subvencionimit të akcizës së naftës për fermerët, tani do të krijojmë skemën kombëtare të sigurimit të prodhimit bujqësor nga fatkeqësitë natyrore. Fermeri nuk do të presë më muaj të tërë për vlerësime dhe dëshmshpërblime. Do të ndërtojmë sistem të strukturuar sigurimi që mbron ekonominë familjare dhe prodhimin vendor.

Investime në Prodhimin Bazë dhe Modernizimin e Fermave

Do të rrisim investimet në prodhimin vendor bujqësor përmes mbështetjes direkte të fermave, pemishteve, serrave, blegtorisë dhe prodhimit të vezëve. Fermerët do të mbështeten për blerjen e mekanizimit modern, ndërtimin e serrave bashkëkohore, instalimin e sistemeve të ujitjes, përmirësimin e stallave dhe rritjen e cilësisë së prodhimit të qumështit dhe mishit. Investimet do të ndihmojnë në uljen e kostos së prodhimit, rritjen e rendimentit dhe forcimin e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore të Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

Çertifikimi – treg i garantuar

Të gjitha prodhimet e fermerëve tanë do të përkrahen në standardizim, certifikim dhe shitje. Çdo prodhim i standardizuar dhe i certifikuar do të ketë treg të garantuar. Prodhimet tona të certifikuara do të jenë të mbrojtura me ligj, si në vend ashtu edhe në Bashkimin Evropian.

Organizimi i Prodhuesve – Fuqizimi i Tregut

Do të mbështesim gjatë mandatit të ri krijimin e organizatave të prodhuesve, kooperativave bashkëkohore dhe bashkëpunim ndërmjet fermerëve për grumbullim, përpunim deri tek shitja e përbashkët të prodhimit. Kështu i rrisim kapacitetet për eksport dhe sigurojmë kontraktim të produkteve bujqësore.

Përpunimi - Standardizimi - Eksporti

Prioritet do të jetë zhvillimi i kapaciteteve për përpunimin e mishit dhe qumështit, magazinimin, zinxhirin e ftohtë dhe standardizimin e produkteve bujqësore. Qeveria do mbështesë investimet në certifikimin për eksport sipas standardeve evropiane, për t'u mundësuar fermerëve dhe prodhuesve të Kosovës qasje në tregjet rajonale dhe evropiane.

Aplikim për grante gjatë gjithë vitit

Do të hapet mundësia për aplikim për grante gjatë gjithë vitit. Kështu, fermeri nuk do të ketë ngarkesën dhe stresin e përgatitjes së projekt-aplikimit në një kohë të shkurtër. Ai do të përgatitet më mirë dhe do të aplikojë në sektorin ku ka përvojë dhe treg për shitje. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zgjatjes së sezonit prodhues, rritjes së vlerës së prodhimit dhe aspektit shumëqëllimor.

Grante për fermerë të papërkrahur

Do të përkrahim fermat dhe fermerët me grante të vogla për t'i bërë më rentabile, përmes bashkëpunimit, standardizimit, grumbullimit, përpunimit dhe kontraktimit të prodhimit me blerësit.

Grante për vajzat e djemtë në bujqësi

Kemi planifikuar mbështetje dedikuar të rinjve që investojnë në bujqësi, përmes financimit të fermave të reja, serrave moderne, mekanizimit dhe pajisjeve bujqësore. Prioritet do të kenë projektet inovative, bujqësia ekologjike, prodhimi me vlerë të shtuar dhe iniciativat që hapin vende pune në zonat rurale. Do të mbështeten gjithashtu trajnimet profesionale, përdorimi i teknologjisë dhe lidhja me tregun.

Aplikim për subvencione online

Pas eliminimit të dhjetëra dokumenteve dhe ditëve të humbura për aplikim për subvencione, që në vitin e dytë të mandatit do të krijohet mundësia për të aplikuar nga shtëpia. Fermeri do të mund ta përcjellë online dhe përmes telefonit procesin, nga aplikimi deri te pagesa e subvencionit.

“Karta e-Fermeri”

“Karta e-Fermeri” do të ketë identitet dhe integritet të mbrojtur. Ajo do të jetë e sigurt për blerjen e inputeve, marrjen e këshillave, përfitimin e subvencioneve, qasjen në financa dhe deri te shitja e prodhimit. Karta garanton që blerja e pesticideve, plehrave dhe farërave të jetë e duhura dhe e saktë, në sasi dhe cilësi, për secilin fermer dhe për çdo kulturë që kultivon. Kështu eliminohen dokumentet për institucionet publike dhe private. Karta do të gjurmtojë dhe standardizojë procesin e certifikimit, duke përfshirë drejtoritë komunale, barnatoret bujqësore, trupat certifikues dhe bankat.

Punësimi Sezonal në Bujqësi

Do të krijohet një sistem i thjeshtë elektronik për regjistrimin e punëtorëve sezonalë në bujqësi. Bujqit dhe bizneset bujqësore do të mund t'i regjistrojnë përkohësisht punëtorët pa procedura të rënda burokratike, duke formalizuar punën sezonale, ulur informalitetin dhe garantuar mbrojtje bazike e siguri më të madhe për punëtorët dhe punëdhënësit.

Tre zona të hortikulturës intensive

Do të krijojmë tre zona të hortikulturës intensive për të forcuar prodhimin vendor, për të hapur vende të reja pune dhe për t'u dhënë fermerëve më shumë siguri ekonomike. Me investime në sera moderne, ujitje, grumbullim dhe përpunim, do ta mbështesim bujqësinë prodhuese dhe do të krijojmë kushte që fermerët tanë të prodhojnë më shumë, më mirë dhe të konkurrojnë denjësisht në tregun vendor e ndërkombëtar.

Prodhimi bujqësor ekologjik

Do të mbështesim zhvillimin e prodhimit bujqësor ekologjik, përmes subvencioneve, certifikimit dhe investimeve në praktika të qëndrueshme bujqësore. Qëllimi ynë është të rrisim prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor, të mbrojmë tokën dhe burimet natyrore, si dhe t'u krijojmë fermerëve mundësi më të mëdha për eksport dhe qasje në tregje me vlerë më të lartë.

Rrjeti i ujitjes

Do të bëjmë rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes.

Aty ku ka sistem ekzistues, ai do të rehabilitohet dhe modernizohet.

Aty ku mungon, do të planifikohet shtrirja e tij, së bashku me rregullimin e parcelave, ndërtimin e rrugëve rurale dhe sistemin e drenazhimit.

Krahas investimeve në diga, do të rritet intensiteti i investimeve në sisteme të reja dhe efikase të ujitjes.

Me sisteme funksionale dhe moderne të ujitjes, fermeri punon dhe investon në kultura rentabile.

Kështu, ferma shndërrohet në ekonomi prodhuese që siguron tregun vendor dhe rrit eksportet.

Uji i pijes

Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, do të përfundojmë projektimin dhe më pas ndërtimin e të gjithë rrjetit të ujësjellësit në të gjitha lokalitetet e banuara.

Pesë diga të reja

Për të garantuar sigurinë e furnizimit me ujë, do të nisë puna për ndërtimin e pesë digave të reja në Kosovë.

Do të ndërtohen pesë rezervuarë për ujë të pijes, ujitje dhe industri, ndërsa për katër të tjerë janë duke u përgatitur studimet fillestare.

Rezervuarët që do të ndërtohen janë: Rezervuari i Poshtëm i Firajës, Rezervuari i Pollatës, Rezervuari i Kuçicës, Rezervuari i Dragaçinës dhe Rezervuari i Desivojcës.

Kanalizimet

Në fshatrat tona ka shumë probleme me kanalizimet.

Zgjidhja që e adreson me efikasitet këtë problem madhor janë impiantet e vogla.

Çdo fshat i madh dhe grup fshatrash do të ketë impiantet e veta të trajtimit të ujërave.

Puna me impiantet e vogla do të nisë nga kanalizimet pranë rrjedhave të lumenjve dhe burimeve ujore.

Lumenjtë

Mbrojtja nga përmbytjet do të adresohet përmes një aksioni për riparimin dhe ndërtimin e argjinaturave të lumenjve.

Revitalizimi i ekosistemeve ujore do të trajtohet si prioritet strategjik për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Në këtë drejtim do të realizohet revitalizimi i plotë i Ligatinës së Hencit, me fokus në rikthimin e funksioneve natyrore, mbrojtjen e biodiversitetit dhe krijimin e një hapësire të qëndrueshme ekologjike.

Paralelisht, do të nisë rigjallërimi i rrjedhës së Lumit Lepenc dhe Lumit Drin përmes rehabilitimit mjedisor, pastrimit dhe rregullimit të brigjeve, si dhe ndërtimit të shtigjeve rekreative për ecje dhe çiklizëm, duke i kthyer këto zona në hapësira funksionale për qytetarët dhe turizmin lokal.

Efiçienca dhe menaxhimi i ujit

Për të rritur efiçencën dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujit, do të ofrohet mbështetje financiare për ndërtimin e sistemeve të grumbullimit dhe shfrytëzimit të ujit të shiut për ujitje dhe nevoja sanitare. Kjo masë synon kursimin e burimeve ujore, uljen e kostove për familjet dhe bizneset, si dhe krijimin e praktikave më të qëndrueshme në përdorimin e ujit.

ENERGJIA DHE MINIERAT

Përballueshmëria e çmimeve, pavarësia energjetike dhe ndikimi në shëndet janë parësore në politikën tonë energjetike. Prandaj, do të investojmë në kapacitete elektroenergjetike që bazohen në burime vendore, në sisteme të ngrohjes qendrore dhe në efikasitet të energjisë. Njëkohësisht, do të punojmë për modernizimin e sistemit energjetik dhe integrimin e tregut të energjisë elektrike në nivel rajonal dhe evropian.

Siguria energjetike dhe diversifikimi i burimeve

Për siguri të furnizimit, do të vazhdojmë investimet në njësitë e termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”, të cilat rrisin kapacitetin e tyre për së paku 20 vite dhe do të ulin ndotjen, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Me modernizimin dhe vendosjen e filterëve që tashmë janë duke u realizuar, kapaciteti prodhues i termocentralit “Kosova B” po rritet për së paku 20%, emetimet e pluhurit do të ulen për 97%, ndërsa emetimet e oksideve të azotit ulen për 75%.

Ndërsa, me rehabilitimin e thellë të njërive të termocentralit “Kosova A”, kapaciteti prodhues do të rritet për 60%.

Me investime publike dhe përkrahjen e investimeve private, kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të rriten më se trefish. Vetëm nga projektet të nisura tashmë, do të kemi së paku 305 MW kapacitete të erës dhe 250 MW kapacitete diellore, duke arritur që 20% e energjisë që konsumojmë të vijë nga burimet e pastra të energjisë.

Si rezultat i të gjitha këtyre investimeve, Kosova do të bëhet neto eksportuese e energjisë elektrike. Më shumë se 93% e energjisë elektrike për familjet dhe ndërmarrjet e vogla do të sigurohet nga burimet vendore, ndërkohë që eksporti i energjisë elektrike në raport me konsumin do të tejkalojë 30%.

Fleksibiliteti i rrjetit elektroenergjetik

Sistemi i baterive për rezerva 340 Mwh do të rrisë stabilitetin e rrjetit elektroenergjetik, do të mundësojë integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në rrjet, dhe do të kontribuojë në përballueshmërinë e çmimeve duke ulur kostot e shërbimeve ndihmëse dhe duke mundësuar ruajtjen e tepricave të energjisë për t’i përdorur kur kërkesa është e lartë.

Teknologjitë e reja

Do të planifikojmë gazifikimit të qymyrit për prodhim të energjisë. Njëkohësisht, do të intensifikojmë bashkëpunimin për ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta energjetike me Shqipërinë.

Integrimi i tregut elektroenergjetik

Pas bashkimit të tregut të energjisë elektrike me Shqipërinë përmes Bursës Shqiptare të energjisë elektrike “ALPEX” në vitin 2024, do të vazhdojë integrimi rajonal i tregut, duke rritur likuiditetin e tregut dhe konkurrencën e transparencën në tregtimin e energjisë elektrike.

Paralelisht, do të bëhen përgatitjet për integrimin e Kosovës në tregun evropian të energjisë elektrike.

Ngrohja qendrore në të gjitha rajonet

Do të ndërtojmë sisteme të reja të ngrohjes qendrore dhe do të dyfishojmë kapacitetin dhe mbulueshmërinë e ngrohjes qendrore në Prishtinë.

Gjatë mandatit do të përfundojë dyfishimi i kogjenerimit në Termocentralin “Kosova B”, projekti i ngrohjes qendrore në Obiliq dhe ngrohja qendrore solare në Prishtinë.

Pa vonesa fillon puna me projektet për ngrohje qendrore në qytetet Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Podujevë dhe Lipjan.

Me vënien në funksion të këtyre sistemeve, nevoja për ngrohje me energji elektrike dhe rrjedhimisht për import të energjisë elektrike do të ulet ndjeshëm.

Ndikimi në mjedis do të jetë i shumëfishtë, duke ulur ndotjen nga djegia e drurit dhe qymyrit, si dhe prerjen e pyjeve.

Efiçienca energjetike për familjet dhe bizneset

Do të vazhdojmë investimet në efiçiençë të energjisë, në vlerë prej 150 milionë euro, për familjet që kanë nevojë për përkrahje në izolimin e shtëpive të tyre, si dhe për përmirësimin e kushteve në ndërtesat publike si shkolla, spitale, salla sportive dhe institucione të tjera.

Kështu sigurojmë kushte më të mira jetese, ngrohje me çmime të përballueshme dhe lehtësim të ngarkesës në rrjetin elektroenergjetik.

Do të rinovojmë 400 ndërtesa publike si shkolla, spitale, etj., dhe do të përkrahim financiarisht së paku 8 mijë familje për izolimin e shtëpive të tyre apo investime të tjera në efiçiençë të energjisë.

Do të nisim rinovimi e banesave shumëkatëshe në komunat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Podujevë dhe Gjakovë.

Do të përkrahim bizneset me grante për sisteme solare dhe efiçiençë të energjisë.

Minierat

Sektori minerar është sektor strategjik me rëndësi për ekonominë dhe sigurinë kombëtare.

Prandaj, do të themelojmë partneritete strategjike në nivel shtetëror për hulumtime dhe investime të përbashkëta në këtë sektor.

Do të ndahet një fond prej rreth 50 milionë euro për skanimin e plotë të burimeve tona natyrore dhe për futjen e tyre në ekonomi në funksion të zhvillimit.

Trepça

Trepça do të jetë në qendër të sektorit minerar, ndërkohë që hulumtimet dhe investimet do të zgjerohen edhe në zona të tjera me potencial të lartë.

Në Trepçë, si bashkëinvestitor, do të inkuadrohet një korporatë minerare me përvojë të gjatë, në bashkëpunim të ngushtë me një nga vendet mike.

Ajër i pastër për të gjithë dhe mbrojtja natyrore urbane

Do të ndjekim politika aktive për uljen e ndotjes së ajrit, përmes rregullave parandaluese jo vetëm ndëshkuese dhe inspektimeve të rregullta ndaj ndotësve të mëdhenj dhe të mesëm.

Do të vendosim sistem të informimit në kohë reale për cilësinë e ajrit, si dhe masa të qarta e të menjëhershme për adresimin e ndotjes.

Do të krijohet Brezi i Gjelbër Prishtinë–Obiliq–Fushë Kosovë përmes pyllëzimit masiv dhe krijimit të korridoreve të gjelbra mbrojtëse, me qëllim të reduktimit të ndotjes së ajrit dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit në zonën më të prekur nga ndotja në vend.

Do të realizohet gjelbërimi sistematik i autostradave dhe rrugëve nacionale, duke i shndërruar ato në korridore ekologjike që kontribuojnë në absorbimin e ndotjes, uljen e ndikimit klimatik dhe përmirësimin e peizazhit mjedisor në të gjithë vendin.

Aksioni “Pa mbeturina dhe pa deponi ilegale”

Do të mbyllim të gjitha deponitë ilegale dhe do të krijojmë një sistem të ri, modern dhe të sigurt për menaxhimin e mbeturinave.

Do të ketë monitorime dhe inspektime të rregullta, si dhe ndëshkime të ashpra për ndotësit.

Do të vendosen standarde të qarta dhe të detyrueshme për menaxhimin e mbeturinave në të gjitha komunat e vendit.

Po ashtu, do të zbatohet sistem i shpërblimit dhe ndëshkimit për komunat, sipas respektimit të standardeve të menaxhimit të mbeturinave.

Brenda këtij mandati do të mbyllim përfundimisht deponinë e Mirashit, duke i dhënë fund ndotjes shumëvjeçare në zonën e Obiliqit. Ky është hapi ynë vendimtar për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Në të njëjtën kohë, do të caktojmë lokacionin e ri për ndërtimin e një deponie moderne për rajonin e Prishtinës, e cila do të funksionojë sipas standardeve më të larta ekologjike.

Mbrojtje nga përmbytjet dhe valët e të nxehtit

Do t'i mbrojmë qytetarët nga përmbytjet dhe valët e të nxehtit. Funksionalizohet sistemi i paralajmërimit në kohë reale, do të ripyllëzohen brigjet e lumenjve për të parandaluar vërshimet dhe do të ndihmohen komunat në pastrimin dhe rikonstruksionin e kanaleve kulluese.

Mbrojtja e Natyrës

Menjëherë do të nisim *Aksioni shtetëror për mbrojtjen e natyrës*, për të ndaluar degradimin e lumenjve, pyjeve dhe zonave të mbrojtura.

Do të forcohet kontrolli mjedisor, gjobat dhe ndëshkimet për shkelësit, ndërsa paralelisht do të fillojë rehabilitimi i ekosistemeve të dëmtuara, pastrimi i lumenjve dhe largimi i pengesave fizike, rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe ruajtja e biodiversitetit.

Blinaja – Nga rezervat i mbyllur në park edukativ dhe rekreativ

Blinaja do të transformohet në një park modern edukativ dhe rekreativ të jetës së egër, sipas modelit “Open-Range Wildlife Park”, duke ruajtur habitatin natyror dhe biodiversitetin e zonës. Projekti parasheh ndërtimin e shtigjeve të sigurta për vizitorë, pikave të vëzhgimit për vëzhgimin e kafshëve në natyrë, laboratorëve edukativë për fëmijë dhe një qendër moderne për vizitorë. Përmes këtij transformimi, Blinaja do të hapet për qytetarët si hapësirë e edukimit mjedisor, rekreacionit dhe turizmit natyror.

Hekurudhat

Në mandatin e ri do të fillojmë më ndërtimin e linjës hekurudhore Gjakovë – Shkodër dhe do të projektojmë linjën hekurudhore që lidh Prizrenin e Ferizajin me Gjilanin dhe Bujanocin. E nisim përgatitjen e linjës Prishtinë – Aeroport.

Rrjeti i Rrugëve

Projektet e mëdha infrastrukturore të mandatit të ri janë sigurimi i lidhjes me koridoret kryesore rrugore, përmes përfundimit të autostradës së Gjilanit deri në Dheu i Bardhë dhe kyçjes në “Korridorin 1”.

Përfundimi i rrugës që lidh Prizrenin me Tetovën.

Ndërtimi i rrugës së Dukagjinit, e cila lidh Prizrenin, Rahovecin, Gjakovën dhe Deçanin me Pejën dhe Istogun.

Rrugët Dollc – Gjakovë dhe Kijevë – Zahaq do të finalizohen, krahas rehabilitimit dhe modernizimit të të gjitha rrugëve rajonale.

Lidhjet ndërkufitare

Përgatitja dhe ndërtimi i sa më shumë akseve rrugore lidhëse ndërkufitare, me qëllim përmirësimin e lidhjes ndërmjet vendbanimeve në Kosovë dhe atyre në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.

Infrastruktura për qendrat historike dhe turistike

Sigurimi i qasjes përmes infrastrukturës së ndërtuar, të mirëmbajtur dhe të rehabilituar në mënyrë cilësore, në të gjitha qendrat me rëndësi turistike, historike, ekonomike dhe afariste.

Ndriçimi i autostradave

Programi i ndriçimit smart për të gjitha autostradat do të fillojë në këtë mandat të ri, duke rritur sigurinë në qarkullim si dhe eficiencën dhe kursimin e energjisë.

Porti i thatë

Ndërtimi i Portit të thatë i cili e vendos Kosovën në hartën ballkanike të transportit të mallrave është një nga projektet madhore që do ta finalizojmë.

PROJEKTET KAPITALE

Dy vitet e fundit të mandatit kemi shënuar rekorde në planifikimin dhe ekzekutimin e investimeve kapitale, dhe këtë ritëm do ta ruajmë e përshpejtojmë edhe më tej në mandatin e ri, përmes reformimit të thellë të sistemit të prokurimit publik.

Reforma do të sigurojë procese më efikase, transparente dhe konkurruese, që sjellin vlerë reale për parandalon publike, në mënyrë që ekzekutimi vjetor i investimeve kapitale të tejkalojë **1 miliard euro** dhe të shndërrohet në standard të qeverisjes.

Pas krijimit të sistemit për gjurmimin e faturave, i cili garanton që çdo faturë e operatorëve ekonomikë paguhet në kohë, gjatë vitit 2025 është kompletuar dhe integruar edhe sistemi i menaxhimit të financave publike me sistemin e e-prokurimit. Ky integrim forcon disiplinën fiskale, rrit llogaridhënien dhe parandalon futjen e organizatave buxhetore në detyrime financiare pa mbulesë, duke garantuar stabilitet dhe besueshmëri në menaxhimin e fondeve publike.

BUXHETI I KOMUNAVE

Me finalizimin e regjistrimit të popullsisë do të nisë një transformim i thellë dhe i qëndrueshëm në mënyrën e buxhetimit për komunat.

Skema e granteve do të përshtatet në përputhje me të dhënat e reja nga regjistrimi, duke siguruar që çdo komunë të marrë financa sipas nevojave reale të popullsisë së saj.

Granti i katërt do të zbatohet gjithashtu, duke u integruar në këtë skemë të re dhe të përmirësuar të buxhetimit.

Buxhetimi i bazuar në të dhëna të sakta mbi popullsinë do të sjellë një transformim të pakthyeshëm në kapacitetet dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ai do të mundësojë përmirësimin e ndjeshëm të kushteve për edukim dhe arsimin parauniversitar, shërbimeve shëndetësore, si dhe rritjen e investimeve në infrastrukturën urbane dhe rurale.

Përveç kësaj, do të përforcohen infrastrukturën e ujësjellësve dhe kanalizimeve, duke garantuar që qytetarët të kenë shërbime më cilësore, efikase dhe të aksesueshme në çdo pjesë të vendit.

Ky model i ri i buxhetimit do të vendosë standarde të reja në qeverisjen komunale, duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social në të gjitha komunat e Kosovës.

SPORTET

Lojërat Mesdhetare 2030

Lojërat Mesdhetare 2030 janë shtylla kryesore e transformimit të Kosovës në një epiqendër sportive në rajon dhe më gjerë.

Infrastruktura sportive

Pallati i Rinisë dhe Sporteve dhe Qendra e Studentëve në Prishtinë do të kthehen në hapësira moderne mikpritjeje, që do t'u shërbejnë qytetarëve për dekada.

Qendrën Akuatike dhe pishinat gjysmë-olimpike, do të jenë themeli i zhvillimit dhe cilësisë.

Palestrat sportive do të modernizohen të gjitha sipas standardeve ndërkombëtare.

Do të realizohet gjithashtu infrastrukturë e re për sportet olimpike, atletikën, tenis, gjimnastikën dhe notin.

250 milionë euro për ndërtimin e 20 stadiumeve të futbollit

Plani ynë për infrastrukturën e futbollit, duke përfshirë Stadiumin Kombëtar dhe të gjitha stadiumet ekzistuese është transformimi i plotë i tyre dhe ndërtimi të reja. Andaj janë planifikuar 250 milionë euro.

Qeverisja e sportit

Politikat tona do të vazhdojnë të forcojnë sistemin sportiv, duke u fokusuar në qeverisje të drejtë, integritet, profesionalizëm dhe barazi. Sporti do të mbështetet në meritë, llogaridhënie dhe integritet. Financimi i aktiviteteve sportive do të lidhet drejtpërdrejt me performancën, planifikimin dhe përgjegjësinë, ndërsa keqpërdorimi dhe favorizimi do të luftohen me zero tolerancë.

Buxhet dhe mbështetje për klubet e vajzave dhe të drejtuara nga ato

Programi i ri, i mbështetur fuqishëm nga qeveria, do të përqendrohet në mbështetjen financiare të klubeve sportive të vajzave dhe të klubeve të drejtuara nga vajzat, duke përfshirë gjithçka, nga pagesat për trajneret deri te subvencionimi i veçantë i këtyre klubeve.

Edukimi profesional dhe transformativ për drejtuesit

Sporti bashkëkohor kërkon ekspertizë shumëdisiplinore. Për këtë, do të forcojmë kapacitetet e federatave, klubeve dhe institucioneve përmes programeve të specializuara në menaxhim sportiv, shkencë sportive dhe mbështetje të sportistëve gjatë dhe pas karrierës së tyre.

Mbështetje për trajnerët – sistemi i licencimit

Trajnerët janë baza e cilësisë sportive. Do të standardizojmë licencimin, trajnimin dhe avancimin profesional të tyre përmes programeve shtetërore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Bashkë me Ministrinë e Arsimit, në mësimin gjithëditor do të koordinojmë programin “Sporti në Shkollë” dhe do të krijojmë hapësira publike për aktivitet fizik.

Gjithashtu, do të sigurojmë modernizimin e stadiumeve, palestrave dhe terreneve ekzistuese në të gjithë vendin, në përputhje me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që sporti të jetë i qashtë për qytetarë të të gjitha moshave, gjinive dhe komuniteteve.

Arti dhe krijuesit kanë mbështetje të plotë dhe të vazhdueshme. Synimi për mandatin e ri është zhvillimi i politikave të ekonomisë kreative.

Industria kreative

Industritë kreative i konsiderojmë si një motor për zhvillim ekonomik dhe shoqëror. Për sektorin kreativ janë parashikuar 200 milionë euro investime, që do të shndërrojnë Kosovën në qendër rajonale të festivaleve, me produkte kreative të standardit ndërkombëtar për tregun lokal dhe ndërkombëtar. Ky investim strategjik e bën vendin prodhues konkurrues në marketing, arkitekturë, librin, artin skenik dhe vizual, dizajn industrial dhe modë, film, artizanat, videolojëra dhe shërbime TIK.

Pronësia intelektuale

Sigurojmë dinjitet dhe mbrojtje sociale për krijuesit. Vendosim një kornizë ligjore të avancuar që njeh dhe mbron punëtorin e pavarur, forcon të drejtat e autorit, siguron monetizimin e drejtë të pronësisë intelektuale dhe garanton konkurrencë të ndershme në treg.

Aftësim gjatë gjithë jetës për krijuesit

Krijojmë një sistem programor dhe institucional të qëndrueshëm për ndërtimin e kapaciteteve në ndërmarrësi kreative dhe teknologji të avancuara, përmes mikro-certifikimeve dhe rezidencave në institucionet më prestigjioze ndërkombëtare.

“Kosova Krijon”

Mandati i ri vjen me një mekanizëm të ri ndërsektorial që koordinon dhe mbështet zhvillimin e industrive kreative, duke siguruar vendimmarrje dhe politika publike adekuate që reflektojnë nevojat dhe prioritetet e sektorit. Mbështesim ngritjen e kualitetit të produkteve kreative dhe nxisim eksportin krahas pjesëmarrjes në ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare.

Kinematë

Do të themelohet rrjeti i kinemave publike në rajonet kryesore të Kosovës, duke koordinuar dhe mbështetur gjithashtu çeljen e kinemave nga ndërmarrësia private.

Mbështetje për artistët

Për krijuesit dhe performuesit, do të vazhdojë mbështetja e artistëve të pavarur dhe e ansambleve rezidente, duke siguruar siguri financiare, autonomi krijuese dhe hapësira dinjitoze për punë. Krijimtarinë artistike do ta lidhim ngushtë me tregun e punës, duke siguruar kompensimin e duhur për prodhimet kulturore.

Objektet e rëndësishme kulturore

Në mandatin e dytë do të vazhdojë modernizimi i objekteve kulturore, duke i transformuar në qendra bashkëkohore krijimi dhe ndërveprimi. Projekte të mëdha, si Teatri i Operës dhe Baletit dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor, do të bëhen pika referimi globale, duke ofruar hapësira të denja për krijimtari dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

Trashëgimia Kulturore

Mandati i parë fokusohet në shpëtimin e monumenteve. Në mandatin e ri, për trashëgiminë

kulturore do të kalojmë nga mbrojtja fizike në **funksionalizim**. Monumentet do të vihen në shërbim të komunitetit dhe ekonomisë, duke ruajtur historinë, fuqizuar identitetin dhe kontribuar në mirëqenien e shoqërisë.

Arkeologjia

Do të mbetet prioritet i lartë përmes investimeve në gjermim, studim dhe menaxhim, ndërsa zonat arkeologjike do të vazhdojnë të jenë prona shtetërore. Qendrat historike do të rijetësohen në shërbim të turizmit, në bashkëpunim me banorët dhe bizneset lokale.

Muzetë dhe Trashëgimia Shpirtërore

Programi për muzetë, i nisur në mandatin e parë, do të zgjerohet në shumë komuna, duke funksionalizuar muze ekzistues dhe duke themeluar muze të rinj. Do të nisë puna konservuese në Kullat e Rezistencës brenda Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Trashëgimia shpirtërore do të dokumentohet dhe promovohet, duke u integruar në planet hapësinore dhe zhvillimore të vendit. Gjatë mandatit të ri do të nisë edhe **Themelimi i Muzeut të Gjenocidit**, ndërsa do të përfundojë Memoriali i Fëmijëve të vrarë gjatë luftës.

Do të vazhdojë konservimi dhe restaurimi i objekteve të kultit. Programi i ri dhe intensiv do të mbështesë **zejet tradicionale** në çdo qytet të Kosovës, duke regjistruar dhe vitalizuar artizanatin lokal.

VLERAT E LUFTËS ÇLIRIMTARE

Krahas themelimit të Ministrisë për Vlerat e Luftës, në mandatin e ri do të vazhdojë mbështetja institucionale për kategoritë e dala nga lufta, përmes forcimit të trajtimit dinjitoz, ruajtjes, dokumentimit dhe promovimit të trashëgimisë së luftës çlirimtare, si dhe zhvillimit të mekanizmave shtetërorë për kujtesën kolektive.

Viktimat civile të luftës

Do të vazhdojë mbështetja institucionale dhe trajtimi dinjitoz për viktimat civile të luftës dhe familjet e tyre, përmes forcimit të përkujdesjes shtetërore, ruajtjes së kujtesës kolektive dhe dokumentimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Të zhdukurit me dhunë

Zbardhja e fatit të të zhdukurve me dhunë nga regjimi i Millosheviqit do të mbetet obligim i pandalshëm shtetëror dhe kombëtar. Pas rikthimit të kësaj çështjeje në qendër të dialogut ndërkombëtar dhe shtimit të presionit institucional ndaj Serbisë për hapjen e arkivave, angazhimi ynë do të vazhdojë deri në ndriçimin e fatit të secilit të zhdukur dhe vendosjen e drejtësisë për familjet e tyre.

DREJTËSIA

Vettingu është proces i domosdoshëm për reformimin dhe rikthimin e besimit në sistemin tonë të drejtësisë, andaj do të vazhdojmë punën për gjetjen e mënyrës së jetësimit të tij në përputhje me Kushtetutën dhe standardet demokratike. Në mandatin e ri do të vazhdojë mbështetja për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, si dhe për sjelljen para drejtësisë të kriminelëve që zbatuan gjenocidin e regjimit të Millosheviqit në Kosovë.

Krahas themelimit të Byrosë për Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe masave të tjera për forcimin e shtetit të së drejtës, do të ndërmarrim iniciativa konkrete që lehtësojnë qasjen e qytetarëve në drejtësi, rrisin efikasitetin institucional dhe garantojnë trajtim më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.

Gjykata për çështje familjare

Çështjet si prona, trashëgimia, dhuna në familje, divorcet dhe alimentacioni nuk mund të presin dekadën për t'u zgjidhur. Familjet dhe problemet e tyre duhet të trajtohen shpejt dhe me efikasitet. Përgjigja jonë është themelimi i Gjykatës për Çështje Familjare, e cila, me prioritet dhe shpejtësi, do t'i trajtojë rastet që qytetarët i adresojnë në gjykata.

Digjitalizimi – padia dhe gjykimi online

Do të **digjitalizohet rrënjësisht sistemi i drejtësisë**. Nga dorëzimi online i padisë deri te zgjidhja e saj, proceset që aktualisht zgjasin deri në pesë vjet për kontestet administrative, civile, komerciale dhe penale, do të bëhen më të shpejta dhe transparente. E njëjta qasje do të zbatohet edhe në nivelin e Apelit dhe Gjykatës Supreme. Sistemi do të lidhet direkt me avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët. Kjo kursen kohë dhe para për çdo familje dhe miliona euro shpenzime nga buxheti i shtetit.

Prokuroria e re e specializuar

Do të themelohet **Prokuroria e re e specializuar për çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit**, e modeluar mbi praktikën më të mira të vendeve evropiane që e kanë përfunduar me sukses këtë betejë. Nuk ka asgjë më të rëndësishme për drejtësinë sesa të sigurohet që institucioni i hetimit të jetë në nivelin e detyrës përballë rrjeteve kriminale të organizuara kundër shtetit dhe rendit ligjor.

Themelimi i Zyrës hetimore disiplinore

Zyra për Hetime Disiplinore do të ketë një strukturë të re që garanton balancë dhe kontroll efektiv ndërmjet pushteteve, duke rritur llogaridhënien e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës për veprimet e tyre. Zyra do të trajtojë ankesat dhe pretendimet për sjellje të papërshtatshme nga gjyqtarët dhe prokurorët. Procesi disiplinor mund të iniciohet edhe **ex officio**. Zyra do të mbledhë provat dhe do t'i paraqesë çështjet përpara Komisioneve Disiplinore të KGJK-së dhe KPK-së.

SIGURIA DHE POLICIA

Siguria publike

Gjatë mandatit të ri do të vijojmë punën për rend dhe ligj në të gjithë vendin pa kompromis. Krahas luftës kundër krimit të organizuar, do të shtohen kapacitetet dhe programet për sigurinë publike. Siguria rrugore, siguria në shkolla dhe policiimi në komunitet do të jenë prioritet i mandatit të ri.

Mbështetje për Policinë – pajisje – shkollim – armatim

Do të vazhdojë mbështetja e Policisë dhe institucioneve të sigurisë me pajisje të specializuara dhe bashkëkohore. Do të rrisim investimet në shkollimin, trajnimin profesional dhe specializimin e zyrtarëve policorë, si në vend ashtu edhe jashtë tij. Njëkohësisht, do të vazhdojë pajisja e Policisë me armatim bashkëkohor dhe adekuat, në shërbim të rendit dhe sigurisë.

Stacione Policore Bashkëkohore

Do të transformohen tërësisht stacionet policore në të gjithë vendin, për të krijuar kushte dinjitoze pune për zyrtarët policorë dhe shërbime më cilësi të lartë për qytetarët. Përmes investimeve në infrastrukturë dhe pajisjeve moderne, stacionet policore do të shndërrohen në hapësira bashkëkohore, funksionale dhe të sigurta, në përputhje me standardet moderne të policimit dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve.

Pensionimi i parakohshëm

Do të nisë një program i pensionimit të parakohshëm të shkallëzuar sipas moshës dhe profileve, duke filluar me themelimin e fondit për këtë qëllim. Faza e parë do të nisë nga mosha 63 vjeç, duke u ulur vit pas viti deri në 55 vjeç.

Përmirësimi i sistemit të gradave

Sistemi i gradave në Policinë e Kosovës do të përmirësohet rrënjësisht. Policëve që gjatë 10 viteve të fundit nuk iu është dhënë mundësia për gradim sipas meritës, do t'u krijohen kushtet për të aplikuar dhe testuar për një ose dy grada njëherazi. Ky proces nis nga 26 qershori 2026. Gjithashtu, me qëllim të mbështetjes së vajzave dhe grave në Polici si dhe avancimit të tyre do të mundësohet organizimi i procedurave të veçanta të gradimit.

Njësia e dronëve dhe antidronëve

Do të avancojmë Njësinë e Dronëve dhe Antidronëve për të forcuar mbikëqyrjen dhe gatishmërinë për t'u përballur me format e reja të rreziqeve të sigurisë, duke ndihmuar në hetime, mbrojtje dhe mbikëqyrje të kufirit, si dhe për rritjen e sigurisë publike në përgjithësi.

Mbrojtja e kufirit

Vendi do të ketë kufij të sigurt dhe të menaxhuar me teknologjitë më të avancuara. Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit do të modernizohet për të garantuar sigurinë, për të lehtësuar qarkullimin e mallrave dhe njerëzve, dhe për të parandaluar aktivitetet kriminale.

Xhandarmëria

Gjatë këtij viti do të iniciohet nisma ligjore dhe do të themelohet Xhandarmëria e Republikës së Kosovës, si një prej prioritetëve të qeverisë për forcimin e kapaciteteve shtetërore të sigurisë. Misioni i saj do të jetë mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, përmes sigurimit të kufijve, luftimit të terrorizmit, menaxhimit të situatave me rrezikshmëri të

lartë dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe objekteve strategjike të vendit. Themelimi i Xhandarmërisë do të mbështetet në përvojën dhe rezultatet e arritura nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policisë e Kosovës, duke iu përgjigjur sfidave të reja të sigurisë në nivel global dhe rajonal.

MBROJTJA

Buxheti i ushtrisë

Për ushtrinë tonë, gjatë katër viteve të ardhshme do të ndajmë mbi 1 miliard euro, duke siguruar fuqizim, pajisje moderne dhe trajnime të avancuara për forcën tonë të armatosur.

Kosova në NATO

Do të thellojmë dhe zgjerojmë bashkëpunimin ndërkombëtar, si bilateral ashtu edhe multilateral, me shtetet anëtare të NATO-s. Me arritjet që ka ushtria jonë, është koha të përshpejtojmë përgatitjet për anëtarësimin në NATO.

Industria Ushtarake “Made in Kosova”

Gjatë mandatit të ri do të zhvillohet industria ushtarake “Made in Kosova”, me fokus në prodhimin e dronëve ushtarakë dhe teknologjive të avancuara për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe gatishmërisë për misionet bashkëkohore. Brenda vitit 2026 do të nisë prodhimi i municionit në Kosovë, ndërsa tashmë është finalizuar zhvillimi i robotëve të parë dhe po punohet për fillimin e prodhimit edhe të pajisjeve të tjera ushtarake, duke forcuar industrinë vendore të mbrojtjes dhe vetëqëndrueshmërinë shtetërore.

Bashkëpunimi me aleatët

Fuqizimi i ushtrisë do të realizohet përmes blerjeve të armatimit, stërvitjes dhe edukimit brenda vendit, në bashkëpunim me Shqipërinë dhe akademitë më të shquara ushtarake të vendeve partnere.

Programet me Shqipërinë

Do të krijojmë Njësinë Ushtarake të Përbashkët me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Së bashku do të nisim programin e fuzionimit për edukimin ushtarak dhe bashkëprodhimin e pajisjeve dhe sistemeve të armatimit.

Rekrutimi i ushtarakëve të rinj

Rekrutimi i kadetëve të rinj do të vazhdojë me ritëm të shtuar. Synojmë që brenda mandatit të ri të kemi 1000 gra dhe vajza ushtarake, duke përfunduar pjesëmarrjen gjinore në ushtri.

Mbrojtja gjithëpërfshirëse – rezervistët vullnetarë

Programi i Mbrojtjes Gjithëpërfshirëse do të zbatohet në të gjithë vendin. Secili rezervist vullnetar do të ketë trajnimin adekuat dhe armatimin personal të nevojshëm për rastet e mobilizimit.

Ushtarakët nga mërgata

Do të mundësojmë kalimin e profesionistëve ushtarakë nga mërgata me origjinë nga Kosova, që shërbejnë në ushtritë e vendeve aleate, në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Të njëjtën mundësi do të kenë edhe profesionistët ushtarakë nga Shqipëria.

Do të forcojmë më tej marrëdhëniet strategjike të vendit me partnerët ndërkombëtarë dhe do të sigurojmë një ushtri moderne, të aftë dhe profesionale, e gatshme për të gjitha sfidat e sigurisë.

POLITIKA E JASHTME

Pasaporta

Fuqizimi i pasaportës së Republikës së Kosovës në të gjitha kontinentet është një nga prioritetet tona kryesore, krahas arritjes së marrëveshjeve dypalëshe për lirin nga regjimi i vizave. Ky hap do të krijojë mundësi të reja ekonomike, tregtare, kulturore dhe arsimore për qytetarët e vendit.

Bashkimi Evropian

Marrja e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian do të mbetet një nga angazhimet tona kyçe.

Marrëveshjet SOFA

Do të dyfishojmë rrjetin e atashëve të mbrojtjes dhe do të zgjerojmë numrin e shteteve partnere me të cilat nënshkruajmë marrëveshje SOFA, duke na afruar drejt anëtarësimit të plotë në NATO.

Marrëdhëniet me shtetet mosnjohëse

Do të zgjerojmë dhe thellojmë marrëdhëniet dypalëshe edhe me shtetet mosnjohëse, veçanërisht ato që janë pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Drejtues të nismave rajonale

Synojmë drejtimin e së paku një nisme rajonale dhe organizimin e konferencave dhe samiteve të rëndësishme në kuadër të integritetit të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Lufta kundër dezinformatave

Do të fuqizojmë kapacitetet e Shërbimit Diplomatik dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për të luftuar dezinformimin që gjenerohet dhe shpërndahet nga vendet autoritare në rajon, Evropë dhe kontinente të tjera.

Shërbimi diplomatik dhe mërgata

Do ta hapim më tej Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik për kuadrot e reja të vendit dhe të mërgatës sonë.

Forcimi i rrjetit të atashëve

Rrjeti i atashëve ekonomik dhe tregtar do të funksionojë si mekanizëm për identifikimin dhe

tërheqjen e investimeve të jashtme, si dhe për gjetjen e tregjeve të reja për eksportin e prodhimeve vendore. Njëjtë do të veprojmë me rrjetin e atasheve kulturor, për promovimin e artit dhe kulturës së vendit, duke krijuar mundësi të reja për artistët dhe studentët e artit.

Aplikimi për anëtarësimin në Bashkimin Evropian

Si demokracia më e avancuar në rajon, me rritje të vazhdueshme ekonomike dhe plotësisht e harmonizuar me politikën e jashtme të BE-së, vizioni ynë është ta përgatisim vendin për t'i bërë ballë konkurrencës rajonale dhe atij evropian, duke ecur përpara në proceset integruese euro-atlantike.

Më 15 dhjetor 2022, zyrtarisht dorëzuam aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian me synimin për marrjen e statusit kandidat. Synimi ynë është që deri në vitin 2030, Kosova të ketë përmbyllur me sukses të gjithë kapitujt nga procesi i integritit dhe të avancojë në negociatat për anëtarësim në BE.

Ne do të sigurohemi që shteti ynë të jetë pjesëmarrës aktiv dhe i barabartë në të gjitha nismat rajonale, duke u angazhuar për integrimin ekonomik të plotë në Tregun e Përbashkët Rajonal dhe për zbatimin e të gjitha obligimeve që dalin nga procesi i Berlinit. Kosova do të jetë plotësisht e harmonizuar me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së Bashkimit Evropian edhe gjatë mandatit tonë të ri.

Plani i zgjerimit të BE-së paraqet një mundësi të shkëlqyer për përshpejtimin e reformave për integrim evropian.

Agjenda e Reformave për vitet 2025-2028 do të jetë prioritet ynë për të përfituar sa më shumë fonde nga BE dhe për përafrim të plotë me Tregun e Brendshëm të BE-së.

Maj-Qershor 2026

Këto janë zotimet tona krahas programeve të reja që kemi planikuar për mandatin e ri që së bashku me ju të dashur qytetarë do t'i kthejmë në një aksion dinamik të gjithanshëm për ta thelluar progresin, solidaritetin, drejtësinë e forcimin e shtetit tonë.